

PERFORMANCA E DREJTËSISË NË NDJEKJEN DHE GJYKIMIN E KORRUPSIONIT

14/25



Autor: Gzim Shala

Me kontribut: Zamira Krasniqi, Flamur Kabashi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e European Endowment for Democracy (EED).

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorinë e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Ngarkesa e sistemit prokurorial me lëndë të korrupsionit	10
3. Aktakuzat e ngritura	11
4. Profili i të akuzuarve	12
5. Ndjekja e (ish) zyrtarëve të lartë	13
6. Koha e kryerjes së veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza	14
7. Dëmi sipas aktakuzave	15
8. Provat e prokurorisë	17
9. Sekuestrimi dhe Konfiskimi	19
10. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të parë	22
11. Vjetërsia e lëndëve aktive në gjyqësor	22
12. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të dytë	23
13. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit	24
14. Mos aplikimi i dënimeve plotësuese	32
15. Parashkrimi i korrupsionit	33

1. Përmbledhje ekzekutive

Kosova vazhdon të përballet me dukurinë e korrupsionit. Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, Kosova është midis një faze të hershme të përgatitjes dhe një niveli të caktuar përgatitjeje në luftimin e korrupsionit dhe ka bërë përparim të kufizuar. Raporti në fjalë, ndër të tjera, thekson se Kosova duhet të miratojë një Strategji Kombëtare kundër Korrupsionit, të përdorë më mirë legjislacionin ekzistues dhe të vazhdojë të forcojë cilësinë e hetimeve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Ky raport paraqet gjetjet e monitorimit dhe hulumtimit të IKD në lidhje me trajtimin e rasteve gjatë vitit 2024 dhe 2025.

Bazuar në monitorimin e IKD, sa i përket ndjekjes penale, në kuptim të ngarkesës me lëndë, rezulton se Prokurori i Shtetit ka pësuar regres në këtë fushë, duke pësuar ngritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura. Gjatë vitit 2024, Prokurori i Shtetit ngriti 293 aktakuza për raste të korrupsionit, ndërsa në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, 151.

Nga gjithsej 444 personat e akuzuar në vitin 2024 dhe 2025, vetëm 11 prej tyre janë zyrtarë të profilin të lartë, apo 2.47%. Kështu, të dhënat tregojnë se gjatë këtyre 2 viteve, ndjekja penale nuk ishte shumë e fokusuar në korrupsionin e profilin të lartë. Për më tepër, nga këto 11 raste, vetëm tre (3) persona janë akuzuar duke mbajtur detyrën zyrtare, derisa të gjithë të tjerët janë akuzuar pasi kanë përfunduar detyrën për të cilën akuzohen. Kështu, gjetjet tregojnë se Prokuroria ka ngritur aktakuza të profilin të lartë kryesisht gjatë kohës kur të njëjtit e kanë përfunduar detyrën zyrtare dhe jo në kohën kur të njëjtit ishin duke ushtruar detyrën e tyre zyrtare.

Sa i përket aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2024, IKD gjen se janë një numër i madh i rasteve për të cilat është ngritur aktakuza shumë vite pasi dyshohet të jetë kryer vepra penale. Psh. Në 3 raste evidentohet se është ngritur aktakuzë për vepra penale që dyshohet se janë kryer në vitin 2016. Ndërkaq, në raport me aktakuzat e ngritura gjatë vitit 2025, rezulton se efikasiteti i Prokurorit të Shtetit ishte më i lartë. Sa i përket dëmit të pretenduar, IKD e gjenë si problematike faktin se në një numër të madh të aktakuzave të ngritura, dëmi i pretenduar nuk është fare i specifikuar. Mos përcaktimi i lartësisë së dëmit në aktakuzë e vështirëson gjykimin, sidomos kur shuma paraqet formë të kualifikuar të veprës penale. Kjo mangësi e vështirëson gjithashtu vendosjen mbi kërkesën pasurore-juridike dhe shqiptimin e dënimit plotësues për kompensimin e humbjes apo dëmit.

Analiza e aktakuzave të viteve 2024–2025 tregon se provat kryesore të propozuara mbeten vendimet, dëshmitarët, raportet dhe deklaratat, ndërsa është vërejtur rritje e përdorimit të komunikimeve elektronike. Masat e fshehta dhe dëshmitarët bashkëpunues u aplikuan vetëm në nga 4 raste secila. Mbështetja kryesisht në deklarata, kontrata, vendime dhe procesverbale i afron hetimet më shumë me një procedurë administrative sesa me një hetim penal për korrupsion. Për këtë arsye, Prokurori i Shtetit duhet të ndryshojë fokusin hetimor, duke kërkuar dhe shqyrtuar

prova më të përshtatshme për natyrën penale të veprave të korrupsionit, në mënyrë që hetimi penal të mos i ngjajë më tepër një hetimi administrativ.

Gjatë viteve 2024–2025, nga 36 aktakuza të analizuara, vetëm në 19% të rasteve Prokurori i Shtetit ka kërkuar sekuestrim ose konfiskim të pasurisë së përfituar me vepër penale, ndërsa në 81% të rasteve një kërkesë e tillë mungon. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë nga moszbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, i cili, ndonëse në fuqi që nga viti 2019, është aplikuar vetëm në 9 raste dhe nga vetëm katër prokurori. Kjo qasje tregon neglizhencë serioze në luftimin e korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë.

Sa i përket gjyqësorit të korrupsionit, IKD gjenë progres të sistemit gjyqësor në raport me ngarkesën me lëndë, duke ulur numrin e lëndëve të pazgjidhura. Kategorizimi i lëndëve të korrupsionit si lëndë me prioritet nuk është reflektuar në praktikë. Përtej afateve të përcaktuara me ligj, IKD gjatë monitorimit ka gjetur raste të korrupsionit të cilat janë aktive në gjykatë, përkundër se aktakuza është ngritur në vitin 2017, pra rreth 8 vite më parë. Në anën tjetër, evidentohen edhe gjithsej pesë (5) raste të cilat janë në proces të gjyqësorit, aktakuzat për të cilat janë ngritur në vitin 2018, pra rreth shtatë (7) vite më parë.

Efikasitet pothuajse të plotë në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka arritur Gjykata e Apelit. Përkundër se ka një progres, çështja e kthimit të rasteve në rigjykim vazhdon të mbetet problem në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit. Gjatë vitit 2024, 12.5% të rasteve të korrupsionit janë kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Kjo përqindje, në nëntëmujorin e parë të vitit 2025 është ngritur në 13.63%.

Në gjykimin e korrupsionit, problematike vazhdon të jetë politika ndëshkimore, e cila ka qenë e orientuar kryesisht në dënime me gjobë dhe me kusht. Bazuar në statistikat e sistemit gjyqësor rezulton se gjatë vitit 2024 në vetëm 32.7% të tyre është shqiptuar dënim me burgim, derisa e gjithë pjesa tjetër e dënimeve kanë qenë dënime me gjobë (47.5%) dhe dënime me kusht (19.6%). Në anën tjetër, bazuar në statistikat e KGJK, rezulton se politika ndëshkimore ishte ende më e butë në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, ashtu që vetëm 10.8% të dënimeve ishin dënime me burgim. Ndërkaq, 23.9% e dënimeve ishin dënime me kusht ndërsa plot 65.2% e dënimeve ishin me gjobë.

Analiza e aktgjykimeve për periudhën 2024–2025 nxjerr në pah se gjykatat vazhdojnë të mos zbatojnë në mënyrë konsistente Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, duke aplikuar rrethana lehtësuese e rënduese pa arsyetim të detajuar dhe duke u përfshirë shpesh në dyfishim të rrethanave. Gjykatat shpesh vetëm përmendin parimet e përgjithshme, pa bërë vlerësim dhe arsyetim konkret të tyre.

Mos zbatimi i dënimeve plotësuese në rastet e korrupsionit është po ashtu aspekt problematik. Megjithatë shqiptimi i tyre në rastet e korrupsionit është obligativ sipas Kodit Penal, analiza e IKD gjenë se ato janë shqiptuar në vetëm në 47.5% të rasteve në vitin 2024 dhe vetëm 11.69% në vitin 2025.

ndjekja e korrupsionit



2. Ngarkesa e sistemit prokurorial me lëndë të korrupsionit

Sikurse në vitin 2024, ashtu edhe në vitin 2025, Prokurori i Shtetit nuk ka arritur të zgjidhë aq lëndë sa ka pranuar, duke shtuar kështu numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

Bazuar në të dhënat e Prokurorit të Shtetit, në vitin 2024 janë trashëguar gjithsej 583 lëndë të korrupsionit, ndërsa ka pranuar edhe 575 lëndë të reja. Përderisa, ka zgjidhur 386 lëndë. Andaj, rrjedhimisht numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2024 kishte arritur në 953.

	TË TRASHËGUARA	TË PRANUARA	TË ZGJIDHURA	TË PAZGJIDHURA
RASTE	583	575	386	953
PERSONA	1650	1324	933	2438

Tabela 1: Ngarkesa me lëndë e Prokurorit të Shtetit për vitin 2024¹.

Situatë e ngjashme del të jetë edhe në vitin 2025. Përderisa në nëntëmuajorin e parë të vitit 2025 ku Prokurori i Shtetit nuk ka arritur të zgjidhë aq lëndë sa edhe ka pranuar. Përballë 338 lëndëve të pranuar, Prokurori i Shtetit ka arritur të zgjidhë 259 prej tyre, duke rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

	TË TRASHËGUARA	TË PRANUARA	TË ZGJIDHURA	TË PAZGJIDHURA
RASTE	704	338	259	880
PERSONA	1864	722	564	2232

Tabela 2. Ngarkesa me lëndë e Prokurorit të Shtetit për vitin 2025².

Në kuptim të ngarkesës me lëndë, kjo situatë paraqet regres në efikasitetin e trajtimit të rasteve të korrupsionit nga ana e Prokurorit të Shtetit. Bazuar në statistikat e Prokurorit të Shtetit, ky

¹ Raporti Vjetor i Komisionit AD-HOC MBIKQYRËS: 2024. Për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike. (Shih linkun: [76997d70-6bfb-4475-a649-bcd3f4fc831f_Raporti-vjetor-i-mekanizmit-percjelles-nderinstitucional-per-veprat-penale-karakteristike-per-vitin-2024.pdf](https://www.ad-hoc.mkd.gov.mk/raporti-vjetor-i-mekanizmit-percjelles-nderinstitucional-per-veprat-penale-karakteristike-per-vitin-2024.pdf)) (Qasur për herë të fundit më 1 dhjetor 2025).

² Komisioni Ad-Hoc Mbikqyrës për Korrupsion dhe Krime Ekonomike. (2025). Raporti Janar–Qershor 2025. (Shih linkun: [4adb794-f513-4b79-88a6-44a36c9ae928_Raporti_i_Komisionit_Mbikqyres_Janar-Qershor_2025_Nr.1798.2025.pdf](https://www.ad-hoc.mkd.gov.mk/raporti-i-komisionit-mbikqyres-janar-qershor-2025-nr.1798.2025.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 1 dhjetor 2025).

institucion e ka filluar vitin 2024 me 583 lëndë, në të cilat bëjnë pjesë 1650 persona. Ndërsa, në fund të nëntë (9) mujorit të parë të vitit 2025, numri i rasteve është ngritur në 880, në të cilat raste janë të përfshira 2232 persona.

3. Aktakuzat e ngritura

Bazuar në raportin vjetor të vitit 2024, për veprat penale karakteristike³, rezulton se gjatë vitit 2024, Prokurori i Shtetit ka ngritur gjithsej 293 aktakuza për rastet e korrupsionit. Numrin më të madh të të akuzuarve përbëjnë rastet e PSRK, 91. Kurse, numri më i vogël i të akuzuarve për raste të korrupsionit vie nga aktakuzat e PTh Gjilan, 15.

Prokuroria	Numri i personave të akuzuar
PSRK	91
PTh Prishtinë	58
PTh Mitrovicë	39
PTh Prizren	26
PTh Ferizaj	25
PTh Pejë	23
PTh Gjakovë	16
PTh Gjilan	15
Gjithsej	293

Tabela 3: Aktakuzat e ngritura nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2024

Përderisa në vitin 2024 numri më i madh i të akuzuarve vie nga aktakuzat e ngritura nga PSRK, kjo Prokurori qëndron e fundit për nga numri i të akuzuarve në nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2025,⁴ me vetëm 3 persona të akuzuar. Në këtë periudhë kohore, prinë PTh në Prishtinë, e cila ka ngritur aktakuza për korrupsion ndaj gjithsej 56 personave.

³ “Raporti vjetor 2024 për veprat penale karakteristike”. Faqe 36. Këshilli Prokurorial i Kosovës. Prishtinë, shkurt 2025. (Shih linkun: [f7f67497-f065-4518-9442-5e99469a8b6a_Raporti-Vjetor-per-vitin-2024-i-Mekanizmit-Percjelles-Nderinstitucional.pdf](https://www.prcjelles-nderinstitucional.pdf)).

⁴ Përgjigje me shkrim nga Prokuroritë Themelore (Prishtinë – 31 tetor 2025; Ferizaj – 10 tetor 2025; Gjilan – 20 tetor 2025; Mitrovicë – 13 tetor 2025; Prizren – 13 tetor 2025; Gjakovë – 17 tetor 2025; Pejë – 8 tetor 2025).

Prokuroria	Numri i personave të akuzuar
PTh Prishtinë	56
PTh Prizren	46
PTh Pejë	13
PTh Gjakovë	11
PTh Gjilan	10
PTh Ferizaj	7
PTh Mitrovicë	5
PSRK	3
Gjithsej	151

Tabela 4: Tabela 3: Aktakuzat e ngritura nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2025

4. Profili i të akuzuarve

IKD ka monitoruar edhe profilin e të akuzuarve në rastet e korrupsionit. Vlerësimi i korrupsionit të lartë është bërë në bazë të kritereve të përcaktuara me nenin 3.1.1.4 të Ligjit NR. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale.

Nga gjithsej 444 personat e akuzuar, vetëm 11 prej tyre janë zyrtarë të profilit të lartë, apo 2.47%.

VITI	ZYRTARË	ISH ZYRTARË	QYTETARË
2024	293	7	2.38%
2025	151	4	2.64%
GJITHSEJ	444	11	2.4%

Kështu, këto të dhëna tregojnë se as gjatë vitit 2024 dhe 2025, ndjekja penale e korrupsionit nuk ka qenë shumë e theksuar ndaj zyrtarëve që hyjnë në kategorinë që përbëjnë korrupsion të profilit të lartë.

5. Ndjekja e (ish) zyrtarëve të lartë

Në dhjetor të vitit 2019, IKD kishte publikuar raportin “Integriteti i sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit”. Në këtë raport theksohej se “Gjetjet e IKD-së, dëshmojnë se aktakuzat e profilit të lartë ndodhin pothuajse gjithmonë vetëm pasi zyrtarët e lartë publikë, nuk ushtrojnë më pozitat e tyre dhe vetëm pasi të njëjtit nuk kanë ndikim të madh politik⁵”.

Për qëllime të draftimit të këtij raporti, IKD ka analizuar 22 aktakuza për korrupsion të ngritura gjatë vitit 2024 (ku përfshihen 83 persona) dhe 14 aktakuza të kësaj natyre të ngritura gjatë vitit 2025 (ku përfshihen 36 persona). Nga totali i të akuzuarve për korrupsion, pa marrë parasysh profilin e të akuzuarve, gjatë vitit 2024 dhe në nëntëmujorin e vitit 2025, shumica e personave janë akuzuar si zyrtarë.

Nëse nga llogaritja largojmë personat e kategorizuar si “qytetarë”, shprehur në përqindje, rezulton se gjatë vitit 2024, 54.7% e personave u akuzuan si zyrtarë, ndërsa 45.3% si ish-zyrtarë. Derisa, përqindja e personave të akuzuar si zyrtarë në krahasim me ish-zyrtarë u ngrit dukshëm në nëntëmujorin e vitit 2025, ku pothuajse të gjithë personat ishin akuzuar si zyrtarë. Konkretisht, nga 24 të akuzuar, 23 ishin zyrtarë, apo 95.8%.

VITI	ZYRTARË	ISH ZYRTARË	QYTETARË
2024	35	29	19
2025	23	1	12

Tabela 5. Ndarja e (ish) zyrtarëve ndaj të cilëve janë ngritur aktakuza gjatë vitit 2024/25.

Megjithatë, në raport me profilin e lartë, ky rezultat nuk qëndron kështu. Nga 11 të akuzuarit të profilit të lartë, vetëm tre prej tyre janë akuzuar për pozitat që mbajnë, ndërsa të tjerët janë akuzuar për poste që nuk i ushtrojnë më. Shprehur në përqindje, i bie se në rastet e korrupsionit të profilit të lartë, vetëm 27.2% e personave janë akuzuar në kohën kur kanë mbajtur detyrën, derisa 72.7% e personave të tjerë janë akuzuar vetëm pasi ata kanë lënë detyrën e tyre.

Përkatësisht, nga shtatë (7) të akuzuarit për korrupsion të profilit të lartë gjatë vitit 2024, asnjë prej tyre nuk është akuzuar duke mbajtur pozitën zyrtare për të cilën akuzohen, ashtu që të gjithë këta persona janë akuzuar si ish-zyrtarë. Ndërkaq, kjo përqindje nuk qëndron kështu në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, ku nga 4 zyrtarët e akuzuar, vetëm njëri është akuzuar si ish-zyrtarë, derisa tre (3) të tjerët janë akuzuar duke mbajtur pozitën zyrtare për të cilën akuzohen.

Në përgjithësi, nëse marrim për bazë rezultatet e monitorimit të vitit 2024 dhe ato të nëntëmujorit të vitit 2025, rezulton se Prokuroria ka ngritur aktakuza të profilit të lartë kryesisht gjatë kohës kur

⁵ Miftaraj, E./ Musliu, B./ Mehmeti, H. “Integriteti i Sistemit të Drejtësisë në Luftimin e Korrupsionit”. Insituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Dhjetor 2018. f.4. (Shih linkun: [IKD-Raporti-SHQIP-FINAL.pdf](#)).

të njëjtit e kanë përfunduar detyrën zyrtare dhe jo në kohën kur të njëjtit ishin duke ushtruar detyrën e tyre zyrtare.

Ndërkaq, ndarazi në vite, ka një situatë pothuajse diametralisht të kundërt në mes të vitit 2024, të gjithë personat janë akuzuar si ish-zyrtarë, nga viti 2025, ku tre (3) nga katër (4) të akuzuarit janë akuzuar gjatë kohës sa kanë qenë duke ushtruar pozitën.

6. Koha e kryerjes së veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza

Në drejtim të luftimit efektiv dhe efikas të korrupsionit, e rëndësishme është që si ndjekja ashtu edhe gjykimi i korrupsionit të bëhet me efikasitet. Zbulimi efikas i korrupsionit paraqet reagim të shpejtë institucional ndaj kësaj dukurie. Rrjedhimisht edhe parandalim dhe gjykim më efikas.

Bazuar në aktakuzat e analizuara për qëllime të draftimit të këtij raporti, efikasiteti, në kuptimin e ngritjes së aktakuzave në raport me kohën kur dyshohet të jenë kryer veprat penale ka qenë më i ulët në vitin 2024 dhe më i lartë në vitin 2025.

Sa i përket aktakuzave të ngritura gjatë vitit 2024, IKD gjen se janë një numër i madh i rasteve për të cilat është ngritur aktakuza shumë vite pasi dyshohet të jetë kryer vepra penale. Psh. Në 3 raste evidentohet se është ngritur aktakuzë për vepra penale që dyshohet se janë kryer në vitin 2016 ndërsa për 4 raste për vepra penale që dyshohet se janë kryer në vitin 2018. Numri më i madh i rasteve të aktakuzave, sipas vitit kur dyshohet të jetë kryer vepra penale është për veprat penale që dyshohet të jenë kryer në vitin 2021 (17 persona të akuzuar).

VITI KUR DYSHOHET TË JETË KRYER VEPRA PENALE	NUMRI I TË AKUZUARVE
2016	3
2018	4
2018 E NË VAZHDIMËSI	16
2019	4
2020	2
2021	17
2021 E NË VAZHDIMËSI	8
2022	12
2023	15
2024	2

Tabela 6. Numri i personave të akuzuar, sipas viteve kur vepra penale dyshohet të jetë kryer, sipas aktakuzave të ngritura në vitin 2024

Sa i përket aktakuzave të vitit 2025, bazuar në aktakuzat e analizuara, reagimi i Prokurorit të Shtetit ka qenë më i shpejtë. Shumica e aktakuzave të ngritura kanë të bëjnë me vepra penale të cilat dyshohet se janë kryer në vitin 2022, derisa evidentohen 6 të akuzuar, veprat e të cilëve dyshohet se janë kryer në vitin 2021.

VITI KUR DYSHOHET TË JETË KRYER VEPRA PENALE	NUMRI I TË AKUZUARVE
2021	6
2022	9
2023	8
2024	7
2025	6

Tabela 7. Numri i personave të akuzuar, sipas viteve kur vepra penale dyshohet të jetë kryer, sipas aktakuzave të ngritura në vitin 2025

7. Dëmi sipas aktakuzave

Sa i përket dëmit të pretenduar përmes veprave penale korruptive për të cilat Prokuroria ka ngritur aktakuza, bazuar në aktakuzat e analizuara për qëllime të këtij raporti, dominon vlera e dëmit në mes të 100.000 deri në 500.000 euro. Rasti me dëmin më të lartë të pretenduar nga Prokuroria është rasti nga ish-Kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi, në të cilin rast Prokurori i Shtetit pretendon se dëmi i shkaktuar arrinë vlerën rreth 37 milion euro.

Sa i përket dëmit të pretenduar, në raport me gjithsej 34 të akuzuar, Prokurori i Shtetit nuk ka përcaktuar fare në aktakuzë dëmin që pretendohet të jetë kryer nga vepra penale.

Dëmi i pretenduar	Numri i personave
0 – 5.000	2
5.000 -10.000	2
10 – 60.000	3

100.000-500.000	22
600.000-900.000	16
3.000.000-5.000.000	1
Mbi 37.000.000	3
Nuk përcaktohet dëmi	34

Tabela 8. Dëmi i përcaktuar sipas aktakuzave për korrupsion të ngritura gjatë vitit 2024

Në vitin 2025, në aktakuzat e analizuara, janë 6 persona që akuzohen për shkaktimin e dëmit në vlerë prej 100 mijë deri 500 mijë euro. Numër i njëjtë i personave akuzohen edhe për vlerën e dëmit 1 deri në 3 milionë euro. Por, dukuria e mos saktësisimit të dëmit në aktakuzë është përsëritur edhe në vitin 2025, i cili dëm nuk është specifikuar fare për 17 të akuzuar.

Dëmi i pretenduar	Numri i personave
0 – 5.000	/
5.000 -10.000	2
10.000-50.000	4
60.000-90.000	1
100.000-500.000	6
1.000.000-3.000.000	6
30.000.000 +	/
Nuk përcaktohet dëmi	17

Tabela 9. Dëmi i përcaktuar sipas aktakuzave për korrupsion të ngritura gjatë vitit 2025

Mos përcaktimi i lartësisë së dëmit të pretenduar në aktakuzë vështirëson gjykimin mbi një aktakuzë të caktuar, veçanërisht nisur nga fakti se në rrethana të caktuara, lartësia e dëmit paraqet formë të kualifikuar të një veprë penale. Po ashtu, mos përcaktimi i lartësisë së dëmit ia vështirëson gjykatës vendosjen mbi kërkesën pasurore juridike si dhe për shqiptimin e dënimit plotësues “urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit”. Për këtë arsye, në secilin rast, Prokuroria duhet të angazhohet që në fazën e hetimeve ta saktësojë lartësinë e dëmit të pretenduar dhe këtë element ta bëjë pjesë të aktakuzës.

8. Provat e prokurorisë

Në mënyrë që të identifikojë se me çfarë provash Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuzat për korrupsion, IKD ka analizuar 36 aktakuza të kësaj natyre, të ngritura nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2024 dhe 2025.

Provat e propozuara	Numri aktakuzave në të cilat është propozuar prova
Prova të tjera	35
Vendime	29
Dëgjimi i dëshmitarëve	26
Raporte të tjera	25
Deklaratat e palëve	25
Deklaratat e dëshmitarëve	19
Procesverbale	18
Kontratat	17
Fotodokumentacione dhe video-incizime	16
Komunikime elektronike	14
Raportet e policisë	13
Ekspertiza	8
Certifikata	6
Vërtetime mbi marrjen e përkohshme të sendeve	5
Urdhërpagesa dhe autorizime për pagesa	5
Dëshmitarë bashkëpunues	4

Transkripta të bisedave	4
Masa të Fshehta	4
Dosja e tenderit	1
Opinione	/
Vërtetime	/
Marrëveshje për pranim të fajësisë	/

Tabela 10. Provat e Prokurorit të Shtetit në rastet e korrupsionit

Nga analizimi i provave të propozuara në aktakuzat e analizuara, të ngritura gjatë vitit 2024 dhe 2025, lloji i provave të propozuara ishin kryesisht vendime, dëshmitarë, raporte, deklarata të palëve, deklarata të dëshmitarëve etj. Ndërsa, në raport me të kaluarën, ka një ngritje të përdorimit të komunikimeve elektronike si prova, të cilat janë propozuar në gjithsej 14 raste. Në vetëm 4 raste, u aplikuan masat e fshehta, në po aq sa edhe dëshmitarët bashkëpunues.

Ngritja e aktakuzave duke u bazuar kryesisht në deklarata të palëve, kontrata, vendime, raporte të policisë, procesverbale etj, më tepër i ngjanë një hetimi administrativ se sa një hetimi penal për vepra penale të korrupsionit. Siç është theksuar nga IKD në raportin e kaluar mbi trajtimin e rasteve të korrupsionit “Nisur nga fakti se korrupsioni, veçanërisht ai i profilit të lartë, është kategori komplekse e veprave penale dhe supozohet se kryhet me një planifikim të madh, kjo kategori kriminale nuk mund të trajtohet me llojet e njëjta të provave të cilat përdoren në rastet e tjera”⁶.

Për këtë arsye, me qëllim të rritjes së efikasitetit në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, Prokurori i Shtetit duhet ta ndërrojë fokusin e hetimit, në kuptim të provave që kërkon dhe shqyrton gjatë një procedure penale. Kjo në mënyrë që hetimi penal i korrupsionit mos të shndërrohet në një hetim që më tepër i ngjanë një hetimi administrativ.

Duhet theksuar se aplikim i teknikave të veçanta hetuese në rastet e korrupsionit është përcaktuar edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit⁷.

⁶ Makshana, L. “Ndjekja dhe Gjykimi i Korrupsionit 2023”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 17. Prishtinë, dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ndjekja-dhe-gjykimi-i-korrupsionit-2023/>). (Qasur për herë të fundit më 01.12.2025).

⁷ “Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”. 2004, neni 50. (Shih linkun: https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025).

9. Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Gjatë periudhës 2024–2025, nga gjithsej 36 aktakuza të ngritura nga Prokurori i Shtetit, të analizuar për qëllime të draftimit të këtij rasti, në vetëm shtatë (7) raste është bërë kërkesë për sekuestrim ose konfiskim të pasurisë së përfutur me vepër penale, ndërsa në 29 raste një kërkesë e tillë nuk është bërë. Shprehur në përqindje, rezulton se vetëm **19%** të aktakuzave Prokurori i Shtetit ka bërë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së përfutur me vepër penale, ndërsa **81%** e aktakuzave janë ngritur pa një propozim të tillë.

NUMRI TOTAL I AKTAUZAVE	RASTE ME KËRKESË PËR SEKUESTRIM/KONFISKIM	RAST PA KËRKESË PËR SEKUESTRIM/KONFISKIM
36	7	29

Tabela 11. Sekuestrimi dhe Konfiskimi i pasurisë sipas propozimit të Prokurorisë

Kjo mënyrë e veprimit tregon se Prokurori i Shtetit nuk i kushton vëmendje të nevojshme luftimit të korrupsionit përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së përfutur në mënyrë të kundërligjshme. Në rast se në aktakuzë Prokurori i Shtetit nuk e parashtron kërkesën për konfiskim, atëherë ai nuk ka mundësinë që këtë çështje ta mbrojë para gjykatës, për faktin se konfiskimi nuk është i përfshirë si pjesë e akuzës. Një qasje e tillë jo vetëm që dobëson efektivitetin e ndjekjes penale, por edhe krijon rrezik real që pasuria e fituar me vepër penale të mos i nënshtrohet asnjë mase, duke e cinguar efektivitetin në luftimin e korrupsionit.

Ky fakt fuqizohet edhe me mos aplikimin e Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Sipas këtij Ligji, pasi një i pandehur shpallet fajtor për një vepër penale, ku hyjnë edhe rastet e korrupsionit, Prokurori i shtetit, mund të parashtrojë kërkesë për verifikimin e pasurisë në gjykatën, e cila e ka nxjerrë aktgjykimin, duke kërkuar verifikimin e pasurisë. Kjo mund të bëhet brenda periudhës pesë (5) vjeçare pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, siç është përcaktuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Barra e provës për Prokurorinë e Shtetit gjatë procedurave për kufizim do të jetë të provuarit e dyshimit të bazuar, derisa pjesa tjetër e të provuarit i takon të pandehurit⁸.

Ky ligj ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Deri më tani, kur po bëhen shtatë (7) vite nga hyrja e tij në fuqi, sipas këtij Ligji janë iniciuar vetëm nëntë (9) raste dhe atë vetëm nga 4 prokurori. Numrin më të madh të rasteve të aplikimit të këtij Ligji e mban PTh në Pejë. Kështu, janë gjithsej katër (4) prokurori të shkallës së parë të cilat nuk e kanë aplikuar këtë ligj në asnjë rast të vetëm.

⁸ Ligjit Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara, neni 2.1.1.2, 4.1 dhe 7.3.

PSRK	2 raste
PTH Prishtinë	1 raste
PTH Prizren	1 rast
PTH Pejë	5 raste

Tabela 12. Zbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit

Kështu, mos propozimi i konfiskimit të pasurisë në aktakuzat e ngritura si dhe mos aplikimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë tregon për një neglizhencë të luftimit të korrupsionit, në kuptim të ndjekjes së tij, përmes konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

Duke e njohur rëndësinë e konfiskimit në fushën e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit, në rastin konkret atij të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, IKD i bënë thirrje sistemit të drejtësisë që të ndryshojë qasje në këtë fushë, duke rritur fokusin në konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Kjo nëpërmjet përfshirjes së propozimit për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale në aktakuzat e ngritura ashtu edhe në aplikimin e Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.

giykimi i korrupsionit



10. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të parë

Bazuar në të dhënat e sistemit gjyqësor⁹, Gjykatat kanë shënuar progres në uljen e numrit të rasteve të korrupsionit. Përderisa në fillim të vitit 2024 numri i rasteve të korrupsionit ishte 251, në fund të nëntëmujorit të parë të vitit 2025 ky numër ka rënë në 176 lëndë. Kjo ka ardhur si rezultat i asaj se gjyqtarët në të dy periudhat kohore, si gjatë vitit 2024 ashtu edhe gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2025, kanë zgjidhur lëndë më shumë se sa që kanë pranuar.

PERIUDHA KOHORE	TË TRASHËGUARA	TË PRANUARA	TË ZGJIDHURA	TË PAZGJIDHURA
2024	251 LËNDË	134 LËNDË	163 LËNDË	222 LËNDË
1 JANAR – 30 SHTATOR 2025	222 LËNDË	91 LËNDË	108 LËNDË	176 LËNDË

Tabela 13. Ngarkesa e gjykatave të shkallës së parë me lëndë të korrupsionit gjatë vitit 2024

Kështu, IKD gjen se gjatë viteve 2024-2025 është shënuar progres sa i përket efikasitetit të trajtimit të rasteve gjyqësore të korrupsionit.

11. Vjetërsia e lëndëve aktive në gjyqësor

Kategorizimi i lëndëve të korrupsionit si lëndë me prioritet absolut nuk është reflektuar në praktikë. Përkundër këtij përcaktimi, IKD evidenton raste kur gjykatat nuk kanë zgjidhur këto lëndë brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Përtej afateve të përcaktuara me ligj, IKD gjatë monitorimit ka gjetur raste të korrupsionit të cilat janë aktive në gjykatë, përkundër se aktakuza është ngritur në vitin 2017, pra rreth 8 vite më parë. Në anën tjetër, evidentohen edhe gjithsej pesë (5) raste të cilat janë në proces të gjykimit, aktakuzat për të cilat janë ngritur në vitin 2018, pra rreth shtatë (7) vite më parë. Këto lëndë, bazuar në monitorimin e IKD, mbeten ende aktive dhe të pazgjidhura nga gjykatat.

Numri i lëndëve aktive në vitin 2024/25 sipas monitorimit të IKD-së	Viti i ngritjes së aktakuzës
1	2017
5	2018
1	2019

⁹ Përgjigje me shkrim nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më 7 nëntor 2025, 10 nëntor 2025)

5	2020
5	2021
5	2022
3	2023
22	2024
13	2025

Tabela 14. Lëndët aktive të korrupsionit në gjykata, sipas viteve të ngritjes së aktakuzës

12. Gjykimi i korrupsionit në shkallë të dytë

Efikasitet pothuajse të plotë në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka arritur Gjykata e Apelit. Tek lëndët e zgjidhura ka progres edhe në Gjykatën e Apelit. Përderisa kjo Gjykatë e ka nisur vitin me 27 lëndë të korrupsionit. Duke zgjidhur 80 lëndë të kësaj natyre, përballë 62 të pranuar, në Gjykatën e Apelit në fund të vitit 2024 kanë mbetur të pazgjidhura vetëm nëntë (9) lëndë. Ndërsa, në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, Gjykata e Apelit zgjidhi gjithsej 22 lëndë të rasteve të korrupsionit, aq sa edhe pranoj, duke mbetur në vetëm nëntë (9) lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

PERIUDHA KOHORE	TË TRASHËGUARA	TË PRANUARA	TË ZGJIDHURA	TË PAZGJIDHURA
2024	27 LËNDË	62 LËNDË	80 LËNDË	9 LËNDË

Tabela 15. Ngarkesa e Gjykatës së Apelit me lëndë të korrupsionit. gjatë vitit 2024.

Sa i përket mënyrës së vendimmarrjes, numri më i madh i vendimeve të Gjykatës së Apelit janë vërtetim i aktgjykimeve të shkallës së parë. Në lidhje me rastet kur Gjykata ka ndryshuar vetëm vendimin mbi dënimin, ka një ekuivalencë relative, ku në shtatë (7) raste është ashpërsuar dënimi ndërsa është zbutur në gjithsej 5 raste.

Përkundër se ka një progres, çështja e kthimit të rasteve në rigjykim vazhdon të mbetet problem në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit. Nga gjithsej 80 lëndë të korrupsionit të vendosura nga Gjykata e Apelit në vitin 2024, në 10 prej tyre kjo Gjykatë ka kthyer rastet në rigjykim. Shprehur në përqindje, rezulton se 12.5% të rasteve të korrupsionit janë kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Kjo përqindje, në nëntëmujorin e parë të vitit 2025 është ngritur në 13.63%.

PERIUDHA KOHORE	TË VËRTETUARA	ASHPËRSUARA	ZBUTUR	RIGJYKIM
2024	64 LËNDË	1 LËNDË	5 LËNDË	10 LËNDË
1 JANAR – 30 SHTATOR 2025	13 LËNDË	6 LËNDË	0 LËNDË	3 LËNDË
TOTAL	77	7	5	13

Tabela 16. Vendimmarrja e Gjykatës së Apelit në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2024

Kthimi i rasteve në rigjykim është problematike e administrit të këtyre rasteve. Kthimi i rasteve në rigjykim është një aspekt që zvarrit procesin e trajtimit të rasteve të korrupsionit dhe ngarkon sistemin e drejtësisë me numër të lëndëve. Kthimi i rasteve në rigjykim interpretohet ose si shmangie nga përgjegjësia e Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit nga vendimmarrja meritore ose si dështim i shkallës së parë për të shmangur shkeljet esenciale, duke detyruar Gjykatën e Apelit të anuloi aktgjykimin e shkallës së parë.

13. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit

Njëra ndër problemet e vazhdueshme të evidentuara në gjykimin e rasteve të korrupsionit është ndjekja e një politike të butë ndëshkimore. Edhe Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2025 thekson se njëra ndër problemet që vazhdon në trajtimin e rasteve të korrupsionit është politika e butë ndëshkimore¹⁰.

Me qëllim të adresimit të politikës ndëshkimore, Gjykata Supreme ka miratuar një sërë udhëzuesish, që tentojnë të harmonizojnë politikën ndëshkimore dhe vendimet e gjykatave mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të jenë adekuate. Në vitin 2018, kjo Gjykatë ka miratuar Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore në Kosovë¹¹, në vitin 2020 ka miratuar Udhëzuesin e Veçantë për Shqiptimin e Gjobjave si Sanksion Penal, në vitin 2021 ka miratuar Udhëzuesin e Veçantë lidhur

¹⁰ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2025, f.30. (Shih linkun: [127563ea-4c03-44a4-b56c-2d569afd86a5_en](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025).

¹¹ “Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. (Prishtinë) 2018 (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025).

me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare¹² derisa në vitin 2024 ka përditësuar Udhëzuesin për Matjen e Dënimit¹³.

Përkundër miratimit të këtyre Udhëzuesve, raportet e IKD kanë theksuar vazhdimisht mos zbatim të tyre në praktikë¹⁴. Mos zbatimi i këtyre udhëzuesve në praktikë ka bërë që Kosova të marrë kritika për ndjekjen e një politike të butë ndëshkimore, derisa këtë e konfirmojnë edhe gjetjet e këtij raporti.

Sipas statistikave të KGjK në vitin 2024 gjatë vitit 2024, prijnë dënimet me gjobë (29 persona), pasuar nga dënimet me burgim (20 persona) dhe dënimet me kusht (12 persona). Shprehur në përqindje rezulton se në rastet e korrupsionit, në vetëm 32.7% të tyre është shqiptuar dënim me burgim, derisa e gjithë pjesa tjetër e dënimeve kanë qenë dënime me gjobë 47.5%) dhe dënime me kusht (19.6%).

Viti 2024						
Dënime me burgim	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dënime tjera	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim refuzues	Është zgjidhur në mënyrë tjetër
13 lëndë	25 lëndë	9 lëndë	0	12 lëndë	2 lëndë	1 lëndë
20 persona	29 persona	12 persona	0	17 persona	9 persona	4 persona

Tabela 17. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2024

Në anën tjetër, bazuar në statistikave të KGjK, rezulton se politika ndëshkimore ishte ende më e butë në nëntëmujorin e parë të vitit 2025. Nga gjithsej 46 dënime të shqiptuara, vetëm pesë (5) prej tyre ishin dënim me burgim, 11 ishin me kusht ndërsa plot 30 dënime ishin dënime me gjobë. Shprehur në përqindje, rezulton se në rastet e korrupsionit, vetëm 10.8% të dënimeve ishin dënime me burgim. Ndërkaq, 23.9% e dënimeve ishin dënime me kusht ndërsa plot 65.2% e dënimeve ishin

¹²Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (Prishtinë) 2021 (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025).

¹³ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II, (Prishtinë) 2024 (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/337_Udhezuesi%20per%20matjen%20e%20denimit_Nentor%202024.pdf) (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025).

¹⁴Shala, G. “Politika e Dënimeve në Kosovë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Nëntor 2019. (Shih linkun: “[Politika-ndeshkimore-ALB-final-2.pdf](#)”); Krasniqi, Z. “Dënimet me gjobë – Leje për Armëmbajtje”. Insituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Shkurt 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/denimet-me-gjobe-lejeper-armembajtje/>); Zekaj, E. “Mos deklarimi i pasurisë, krim në letër, kundërvajtje në praktikë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/mos-deklarimi-i-pasurise-krim-ne-leter-kundervajtje-ne-praktike/>); Krasniqi, Z./ Smajli, F. “Politika Ndëshkimore në Krimet Speciale”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/politika-ndeshkimore-ne-krimet-speciale/>).

me gjobë. Thënë më ndryshe, bazuar në këto statistika, rezulton se pothuajse dy të tretat e dënimeve të shqiptuara në rastet e korrupsionit gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2025 ishin dënime me gjobë.

Viti 2025						
Dënime me burgim	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dënime tjera	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Është zgjidhur në mënyrë tjetër
5 lëndë	24 lëndë	11 lëndë	0	6 lëndë	1 lëndë	0
5 persona	30 persona	11 persona	0	11 persona	1 persona	0

Tabela 18. Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2025

IKD pa hyrë në vlerësimin e meritave të vendimeve gjyqësore në rastet e korrupsionit, thekson se është e qartë se politika ndëshkimore e aplikuar nga gjykatat në rastet e korrupsionit nuk dërgon mesazh të qartë tek personat që potencialisht mund të kryejnë vepra të tilla. Zbatimi i dënimeve të buta sikurse evidentohet si nga Raporti i Komisionit Evropian ashtu edhe nga gjetjet e këtij raporti nuk është në linjë me nevojat e Kosovës në luftën anti-korrupsion. Një politikë e tillë ndëshkimore nuk arrin të realizojë qëllimet e dënimit, veçanërisht në kuptim të parandalimit të dukurisë së korrupsionit. Për më tepër, një politikë e tillë ndëshkimore dërgon një mesazh negativ në publik, duke u përceptuar korrupsioni si një dukuri e pandëshkuar.

Sa i përket politikës ndëshkimore, IKD vazhdimisht ka theksuar shqetësimet për aplikimin e një qasje jo adekuate në këto raste. Edhe pse ka dënime të vazhdueshme për korrupsion – ndonëse jo ndaj profilit të lartë – dukuria e korrupsionit mbetet evidente në Kosovë. Rastet e korrupsionit, përveç rrezikshmërisë së lartë, përmbajnë edhe potencial të madh për të absorbuar rrethana rënduese, të cilat në praktikë shpesh nuk merren parasysh. Mungesa e dënimeve adekuate ndikon që qëllimet e dënimit të mos realizohen plotësisht dhe kontribuon në krijimin e një kulture të pandëshkueshmërisë, e cila vetëm sa e nxit më tej këtë dukuri. Për këtë arsye, IKD i bën thirrje KGJK-së dhe gjykatave që, përtej miratimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore, të angazhohen fuqishëm dhe në mënyrë proaktive në zbatimin e tij në praktikë.

Aplikimi i Rrethanave Lehtësuese dhe Rënduese dhe Zbatimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit

Mosrespektimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore gjatë matjes së dënimit për veprat penale të korrupsionit paraqet problem thelbësor në garantimin e një politike penale konsistente dhe të drejtë. Është me rëndësi që gjykata t'i referohet në mënyrë të saktë dhe

të argumentuar rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke ofruar një shtjellim të qartë për secilën rrethanë të aplikuar dhe duke sqaruar qëllimin e arritur përmes aplikimit të saj¹⁵.

IKD ka analizuar 30 aktgjykime për periudhën 2024–2025 lidhur me zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit, analizë kjo e cila tregon se në shumicën e rasteve gjykatat kanë identifikuar rrethanave lehtësuese dhe rënduese, por pa ofruar shpjegime të detajuara dhe pa mbështetje në prova konkrete të rastit.

1. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në DKR gjatë vitit 2024

Gjatë analizimit të 13 aktgjykimeve të Departamentit për Krime të Rënda për vitin 2024, në tre prej tyre është vërejtur aplikim i dyfishtë i rrethanave. Përveç pranimit të fajësisë, të cilin gjykata e ka trajtuar si rrethanë lehtësuese, janë përfshirë gjithashtu keqardhja dhe pendimi. Udhëzuesi i Gjykatës Supreme¹⁶ shprehet qartësisht se duhet kushtuar kujdes i veçantë shmangies së dyfishimit të rrethanave, pasi një praktikë e tillë mund të çojë në shqiptimin e një dënimi më të butë sesa ai meritohet ose në një dënim më të rëndë kur ka dyfishim të rrethanave rënduese.

Po ashtu, Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Veprat e Korrupsionit Zyrtar përcakton se pranimit të fajësisë duhet t'i jepet një peshë e veçantë, e cila varet nga faza procedurale në të cilën i pandehuri e bën këtë pranim. Kur pranimi i fajësisë realizohet në fazat e hershme të procedurës, ai kontribuon në ekonomizimin e procesit gjyqësor dhe shmangien e kostove të panevojshme, çka justifikon një zbutje më të theksuar të dënimit. Ndërkaq, pranimi i fajësisë në faza të avancuara, veçanërisht pas administrimit të provave, kur i pandehuri është i vetëdijshëm se ekziston mundësia e lartë që ai të shpallet fajtor, e zvogëlon dukshëm efektin zbutës të kësaj rrethane.

Në përputhje me Udhëzuesin, rrethanat që lidhen me aspektin personal të kryesit duhet të kenë peshë minimale në matjen e dënimit dhe nuk duhet të barazohen me peshën e rrethanave që lidhen me dëmin e shkaktuar dhe përgjegjësinë e kryesit të veprës penale¹⁷.

Ndër të tjera, edhe në rastet kur gjykata ka marrë në konsideratë rrethanat personale të kryerësit të veprës penale, ajo nuk ka ofruar një arsyetim të detajuar se përse këto rrethanat janë vlerësuar si të

¹⁵Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë 2018. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.10.

¹⁶ Po aty, 31

¹⁷ Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Prishtinë 2021.(Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.42.

rëndësishme, por vetëm i ka potencuar si rrethanë¹⁸. Kjo rrethanë është aplikuar ndaj 7 personave në aktgjykimet e analizuara.

Po ashtu, një rrethanë që përdoret më shpesh nga gjykatat është sjellja korrekte e kryesit të veprës penale. Kjo rrethanë paraqet një konfuzion thelbësor, pasi që nuk duhet të trajtohet si rrethanë lehtësuese. Udhëzuesi i Gjykatës Supreme për Veprat e Korrupsionit sqaron se paraqitja në gjykatë, mosprishja e rendit gjatë procesit gjyqësor dhe trajtimi i të tjerëve me respekt minimal përbëjnë detyrime themelore të çdo qytetari dhe nuk arsyetojnë zbutjen e dënimit¹⁹. Përndryshe, kjo rrethanë është aplikuar ndaj 6 personave në aktgjykimet e analizuara për vitin 2024.


Në aktgjykimet e vitit 2024, gjykatat kanë aplikuar si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjellja e mëparshme e kryesit si dhe rrethanat personale dhe sjellja e kryesit pas veprës penale, e të cilat janë parime mbi të cilat duhet të bëhet aplikimi i rrethanave rënduese.²⁰

Pra, gjatë aplikimit të rrethanave rënduese, gjykatat as nuk kanë bërë aplikimi të duhur të këtyre rrethanave por në të shumtën e rasteve vetëm kanë përmendur parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të bëhet aplikimi i rrethanave rënduese.

¹⁸ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë 2018.(Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.10.

¹⁹ Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Prishtinë 2021.(Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.44.

²⁰ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë 2018. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.38.



Grafika 1. Rrethanat Lehtësuese dhe Rënduese gjatë vitit 2024

2. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në DKR gjatë vitit 2025


Në analizimin e 13 aktgjytimeve të Departamentit për Krime të Rënda gjatë vitit 2025, është vërejtur një situatë e ngjashme me atë të vitit paraprak. IKD ka identifikuar dy raste ku ndaj dy kryesve të veprës penale është aplikuar dyfishim i rrethanave lehtësuese. Ndonëse të pandehurit kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, gjykata përveç se e ka trajtuar këtë marrëveshje si rrethanë lehtësuese, ka përfshirë gjithashtu në mënyrë të veçantë edhe pendimin dhe keqardhjen. Mirëpo, sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Matjen e Dënimit²¹, pranimi i fajësisë nënkupton në vetvete shprehjen e pendimit dhe keqardhjes për kryerjen e veprës penale dhe si i tillë nuk mund të bëhet aplikimi i tyre si rrethana të veçuara. Për rrjedhojë, përfshirja e tyre individuale përbën dyfishim të rrethanave lehtësuese, gjë që bie ndesh me standardet e përcaktuara nga Gjykata Supreme.

Situata është e njëjtë edhe sa i përket aplikimit të rrethanës së sjelljes korrekte në gjykatë. Siç është theksuar më parë, sjellja korrekte e të pandehurit para gjykatës paraqet një detyrim ligjor dhe jo

²¹Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/337_Udhezuesi%20per%20matjen%20e%20denimit_Nentor%202024.pdf) (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.87.

një zgjedhje, prandaj nuk mund të vlerësohet si rrethanë lehtësuese në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Në aktgjykimet e analizuara për vitin 2025, janë evidentuar gjithashtu dy raste në të cilat kryesit e veprave penale kanë qenë recidivist. Në njërin rast, kryesi ishte dy herë i dënuar më parë për vepra të tjera penale, ndërsa në rastin e analizuar është dënuar me gjobë në shumën prej 2.000 euro²². Në rastin tjetër, i pandehuri kishte qenë i dënuar më herët për një vepër tjetër penale, ndërsa në rastin konkrete është dënuar me gjobë në shumën prej 1.500 euro²³.



Grafika2. Rrethanat Lehtësuese dhe Rënduese gjatë vitit 2025

Sa i përket aplikimit të rrethanave rënduese te shumica e aktgjykimëve të analizuar për vitin 2025 është vërejtur dukuria e njëjtë, pra vetëm janë përmendur parimet e përgjithshme²⁴ në bazë të të

²² Aktgjykimi PKR.nr.17/25


²³ Aktgjykimi PKR.nr.68/24

²⁴ Udhëzues i Përgjithshëm për Matjen e Dënimit, Botimi II. Prishtinë 2024. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/337_Udhezuesi%20per%20matjen%20e%20denimit_Nentor%202024.pdf) (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.24.

cilave duhet të bëhet aplikimi i rrethanave rënduese, e ku nuk është bërë as ndonjë elaborim i rrethanave rënduese.

3. Aplikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në Departamentin Special për periudhën 2024/25

Sa i përket analizës së aplikimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë shqyrtuar gjithsej katër aktgjykime, ku në raport me aplikimin e rrethanave lehtësuese, gjykata në tri raste ndaj 30 kryesëve të veprave penale ka aplikuar rrethanën e sjelljes korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, siç është përmend edhe më lartë, sjellja korrekte në gjykatë nuk duhet të konsiderohet rrethanë lehtësuese²⁵.



Grafika 3. Rrethanat Lehtësuese dhe Rënduese për vitin 2024/25

Po ashtu, edhe ky Departament ka bërë një aplikim thuajse identik sa i përket aplikimit të rrethanave rënduese, ku në shumicën e rasteve vetëm ka përmendur parimet e përgjithshme. Ndër të tjera, gjykata ka marrë parasysh si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale, ani pse kjo parashihet si parim i përgjithshëm mbi bazën e të cilit duhet të merret parasysh aplikimi i

²⁵ Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Prishtinë 2021. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.44.

rrethanave rënduese²⁶, rregulla këto të cilat janë të parapara edhe Kodin nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës²⁷.

Në përgjithësi, gjatë analizimit të aktgjykimeve është evidentuar se zbatimi i rrethanave lehtësuese ka dominuar ndaj atij të rrethanave rënduese, duke reflektuar një qasje më të butë në individualizimin e dënimeve.

14. Mos aplikimi i dënimeve plotësuese

Dënimet plotësuese do të duhej të ishin një nga mjetet kryesore të gjyqësorit për luftën efektive kundër korrupsionit, por që fatkeqësisht këto dënime po vazhdojnë të mos aplikohen ndaj veprave penale të korrupsionit edhe pse sipas legjislacionit në fuqi aplikimi i tyre është obligativ dhe jodiskrecional.²⁸

Megjithatë, në praktikë, nga analizimi i 40 aktgjykimeve dënuese të publikuara në vitin 2024 dhe 48 aktgjykime dënuese të publikuara në vitin 2025, IKD gjen se gjykatat nuk kanë shqiptuar dënimin plotësues “Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik” në as gjysmën e rasteve. Nga 40 personat e dënuar në vitin 2024, aktgjykimet e të cilave janë analizuar për qëllime të draftimit të këtij raporti, IKD gjen se ndaj 19 prej tyre janë shqiptuar dënime plotësuese. Shprehur në përqindje, rezulton se dënimet plotësuese janë shqiptuar në 47.5% të rasteve ndërsa nuk janë shqiptuar në 52.5% të rasteve.

Numri dhe përqindja e këtyre dënimeve plotësuese ka rënë në nëntëmujorin e parë të vitit 2025. Në raport me 77 personat e dënuar, aktgjykimet e të cilëve janë analizuar për qëllime të draftimit të këtij raporti, dënimi plotësues “[n]dalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik” është shqiptuar vetëm në 9 raste. Shprehur në përqindje i bie se Gjykatat kanë shqiptuar dënimet plotësuese në vetëm 11.69% të rasteve ndërsa këtë nuk e kanë bërë në 88.31% të rasteve.

²⁶ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore”. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Prishtinë 2018. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhëzues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf). (Qasur për herë të fundit më 28 nëntor 2025). f.38.

²⁷ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 69.3

²⁸ Kodi Nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Neni 62.3.; Udhëzues i veçantë: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Prishtinë 2021. (Shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/98248_UDHEZUESI%20PER%20VEPRAT%20E%20KORRUPSIONIT-10%20qershor%202021.pdf). (Qasur për herë të fundit 28 nëntor 2025). f.50.

Mosaplikimi i dënimeve plotësuese		
Viti	Persona të dënuar	Dënime Plotësuese
2024	40	19
2025	77	9

Tabela 19. Krahassimi në mes shqiptimit të dënimeve plotësuese nga gjykatat themelore në vitin 2024 dhe 2025.

IKD në vazhdimësi në raportet vjetore të monitorimit të gjykatave kishte kërkuar që këto të fundit të shqiptojnë dënimet plotësuese në rastet e korrupsionit, por që fatkeqësisht kjo praktikë negative ka vazhduar, ku gjykatat me mos aplikimin e dënimeve plotësuese nuk e kanë zbatuar obligimin e tyre sipas Kodit Penal²⁹.

Mos aplikimi i këtyre dënimeve ku kryeseve do ju ndalohej ushtrimi i funksionit në administratë publike cenon rëndë besimin e publikut në gjyqësor por edhe në administratën publike pasi kryesit e këtyre veprave penale pas vuajtjes së dënimit mund të kthehen të ushtrojnë sërish funksione publike. Mbi të gjitha, kjo mënyrë e veprimit paraqet mos zbatim të ligjit nga ana e gjykatave.

15. Parashkrimi i korrupsionit

Gjatë monitorimit, IKD ka evidentuar një rast të korrupsionit i cili është parashkruar gjatë vitit 2025. Aktakuza në këtë rast ishte ngritur në qershor të vitit 2020, ndërsa Gjykata nuk kishte arritur që këtij rasti t'i jap epilog për vite me radhë, derisa ishte arritur afati i parashkrimit. Ky rast ishte parashkruar në vitin 2024, por se konstatimi i parashkrimit ka ndodhur në mars të vitit 2025.

Në këtë rast, bëhet fjalë për parashkrimin e një rasti që ka të bëjë me kryerjen e veprës penale dhënia e ryshfetit, ku ndaj të akuzuarit për këtë rast, që mbante edhe cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, rasti ka arritur afatin e parashkrimit. Ndërkaq, kjo aktakuzë është duke vazhduar të trajtohet në raport me të akuzuarin tjetër i cili akuzohet për veprën penale të marrjes së ryshfetit³⁰.

²⁹ KODI NR. 06/L-074 PENAL i Republikës së Kosovës, neni 62.3.

³⁰ [I parashkruhet vepra të akuzuarit për dhënie ryshfeti, Gjykata merr aktgjykim refuzues ndaj tij - Betimi për Drejtësi](#)

